



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-86
Prishtinë, më 15 dhjetor 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 15 DHEJTOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, kurse munguan: Sabri Hamiti dhe Myfera Shinik, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati, kurse mungoi, Ibrahim Makolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja, Floriana Shala,
Nga NDI-ja, Rinor Beka,
Nga KE, Malva Govori.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës, si dhe për materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 dhjetor 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 dhjetor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 1 dhjetor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet më 18 dhjetor 2009, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping,
5. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë së Privatizimit për periudhën gusht 2008- gusht 2009,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Bordit të komisionit për Miniera dhe Minerale për gjashtë muaj.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për masën e përkohshme për parapagimin e RTK-së

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, konstatoi se duhet bërë konsultime shtesë ndërmjet komisioneve dhe RTK-së, për të shikuar planin buxhetor para se kjo të shqyrtohet në seancë plenare.

3.2 Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e tretë të vitit 2009

Sekretari i Kuvendit, **Ismet Krasniqi** e njoftoi Kryesinë e Kuvendit lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e tretë të vitit 2009, sipas kategorive: për kategorinë – paga e mëditje, janë shpenzuar 80.36%, për kategorinë – mallra dhe shërbime, janë shpenzuar 69.79%, për shpenzimet komunale janë shpenzuar 98.20%, subvencionet janë realizuar 100%, kurse investimet kapitale rreth 67% të mjeteve të parapara.. Ngecjet e projektit në mënyrë konstante janë te vila “Gërmia”, që është paraparë edhe në buxhetin e vitit 2010.

Naim Maloku, ngriti çështjen e projektit vila “Gërmia” dhe kërkoi sqarime lidhur me këtë, që është paraparë edhe në Projektbuxhetin e vitit 2010.

Lidhur me këtë çështje diskutuan: **Xhavit Haliti, Nexhat Daci** dhe **Ibrahim Gashi**, anëtarë të Kryesisë.

Pas këtyre diskutimeve, **Kryesia** vendosi që në mbledhjen e ardhshme të shqyrtohet në hollësi kjo çështje.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së për procedimin e Projektligjit për Prishtinën, në Kuvend

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që Projektligjin për qytetin e Prishtinës, të paraparë me Strategjinë legislative të Qeverisë për këtë vit, ta procedojë në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së për të debatuar lidhur me humbjen e jetës së qytetarëve të Kosovës në lumin Tisa, në kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Përsëritet kërkesa për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të përgatisin informata për rastin e tragjedisë në lumin Tisa, në kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë ku humben jetën disa qytetarë të Republikës së Kosovës.
2. Informatat, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi, të përgatiten dhe t'i dërgohet Kuvendit me urgjencë.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar e AKR-së për të debatuar për mos implementimin e vendimeve të formës së prerë për pronësitë e trajtuara, uzurpime arbitrare, në tokat e pronësisë shoqërore

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga propozuesi, Grupi Parlamentar i AKR-së, që të përgatisë një material bazë për debat, para se mocioni të radhitet për shqyrtim në seancë plenare.

3.6 Njoftimi me skadimin e mandatit të tre anëtarëve të Komisionit për Miniera dhe Minerale

Kryesia, me propozim të Kryetarit, vendosi që seancës plenare, më 18.12.2009, t'i propozojë që tre anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Mineral, t'ua vazhdojë mandatin edhe për gjashtë (6) muaj.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

I rekomandohet Komisionit për Buxhet dhe Financa që, me rastin e shqyrtimit të Projekt-buxhetit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për vitin 2010, të veprojë konform nenit 14 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

3.8 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për rikonfigurimin e pagave të deputetëve, sipas buxhetit të Kuvendit të Kosovës

Kryetari njoftoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimin e Komisioni për Buxhet dhe Financa për konfigurimin e pagave të deputetëve.

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për rikonfigurimin e pagave të deputetëve, si dhe të një pagese shtesë për vitin 2009, për deputetët dhe stafin e Administratës së Kuvendit.

3.9 Informata për realizimin e investimeve kapitale

Sekretari i Kuvendit, **Ismet Krasniqi**, i njoftoi në hollësi anëtarët e Kryesisë për aktivitetet e Administratës në realizimin e investimet kapitale në Kuvendin e Kosovës, në pajtim me buxhetin e paraparë për vitin 2009, siç janë: ndërrimi i dyerve dhe i dritareve të ndërtesës, blerja e makinave për nevojat e Kuvendit, rinovimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, nyjave sanitare, montimi i ashensorit të dytë etj, shumica e të cilave do përfundojnë deri në fund të këtij viti.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale